

Në bazë të nenit 55 alineja 1 i Ligjit për organizim dhe punë të organeve të administratës shtetërore (“ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”) nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 и 51/11) dhe në bazë të nenit 25 paragrafi 2 dhe paragrafi 5 i Ligjit për arsim fillor (, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”) nr. бр. 103/08, 33/2010, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12 и 24/13), si dhe në bazë të nenit 6 dhe 7 paragrafi 1, alineja 4 i Ligjit për Byronë për zhvillimin e arsimit (“ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”) nr. 37/06, 142/08, 148/09, 69/13, 120/13, 148/13), ministri i Arsimit dhe Shkencës e miratoi Programin mësimorë për lëndën e matematikës për klasën e I të arsimit fillorë



MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

PROGRAMI I SHKURTUAR
MËSIMOR

MATEMATIKA

SHTATOR 2020

Klasa I

ARSIMI FILLOR NËNTVJECAR

1. HYRJE

Programi shkurtuar mësimor nga lënda mësimore Matematika bazohet në qëllimet/ rezultatet e pritura të parashikuara në programin regullt mësimor që realizohet sipas planit të paraparë.mësimor.

Në Programi i shkurtuar mësimor janë të prarapara temat dhe njësitë mësimore që duhet të realizohen për 159 ditë mësimore, ku merrret parsysh fondi javor i orëve i përcaktuar në programet e rregullta mësimore 5 orë në javë gjegjësisht, gjithësejt 159 orë.

1. Pasqyra e temave dhe njësive mësimore

TEMA: NUMRI DHE ZGJIDHJA E PROBLEMEVE (107orë)

NJËSITË MËSIMORE:

1. Numrimi prej 0 -10 dhe numrimi nga e prapa prej10 – 0.
2. Numrimi prej 0 -20 dhe numrimi nga e prapa prej 20 – 0.
3. Bën vlerësim të arsyeshëm për disa gjësende që mundet të vërtetohen me numërim deri më 30.
4. Numërimi I gjësendeve deri në 20 dhe lidh sasinë me numrin përkatës..
5. Lexon dhe fillon të shkruajë numra prej 0 deri më 20. (shkruan në ajër, miell,rërë bore etj) numrat prej 0-20
6. Numërimi dhe shkrimi i numrave deri në 5
7. Numërat prej 6 deri në 10.
8. Numërimi deri në 10 dhe nga e prapa
9. Numërimi deri 20.
10. Rradhit numrat në varg më së paku deri në 20
11. Shfrytëzon nocionet „ më shumë,, ose „, më pak,, për të krahasuar dy numra
12. Për një më shumë, për një më pak.
13. Njeh Paraardhësin dhe pasaardhësin deri më 20.
14. E shfrytëzon shenjë „ = „, për të treguar njëllojshmërinë (barazimin
15. Përcakton numrin për 1 më pak dhe për 1 më shumë

16. Fillon ti përcakton çiftet e numrave shuma e të cilëve jep numrat 3,4,5,
17. Fillon të përcakton çiftet e numrave shuma e të cilëve jep numrat 6, dhe 7.
18. Fillon të përcakton çiftet e numrave shuma e të cilëve jep numrat 8 dhe 9
19. Fillon të përcaktoj çiftet e numrave shuma e të cilëve jep numrin 10.
20. Ushtrime për përcaktim e çiftet e numrave shuma e të cilëve jep numrin 10
21. Ushtrime për përcaktim e çiftet e numrave shuma e të cilëve jep numrin 10
22. Zgjidhje e detyrave problemore me numrat çift .
23. Çiftet – mbledh mbledhes të njëjtë 5+5
24. Gjysmat e numrave çift deri më 10
25. Numërimi me nga dy.
26. Numërimi me nga 10
27. Dallimi i numrave çift dhe tek
28. Numërimi deri 100 me dhjetëshe
29. Numërimi me nga 10 deri 100 nga numri konkret (psh nga numri 30)
30. Njohja me shenjat + dhe =
31. Mbledhje deri në dhjetë.
32. Mbledh deri në dhjetë E kupton mbledhjen si numërim përpara dhe kombinimin e dy sasive
33. Mbledh në dy mënyra - komutative
34. Zbritje me nga një
35. Zbritje deri në dhjetë
36. Zbritje si numërim mbrapa dhe marrje të një sasive nga tjetra,
37. Zgjidhja e detyrave matematikore me mbledhje dhe zbritje.
38. Përcaktimi i numrit për 1 ose 10 më i madh ose më i vogël prej cilit do nga numrat nga 0-30
39. Dhjetëshe dhe njëshet
40. Dhjetëshe dhe njëshe – ushtrime
41. Zbritjen si numërim mbrapa dhe marrje të një sasive nga tjetra,
42. Për dy më pak për dy më shumë
43. Shenja „ =“.
44. Gjen çiftet që bëjnë 10 gjatë mbledhjes me kalim deri 20.
45. Mbledhje me kalim deri 20 me shfrytëzim të çifteve të numrit 10
46. Zgjidhje e detyrave matematikore me mbledhje dhe zbritje deri më 10
47. Zgjidhje e detyrave matematikore me mbledhje dhe zbritje deri më 20

48. Zbritje deri më 20
49. DalloN shenjat ,, + ,, ,, - ,, dhe ,, = ,, në shprehjet matematikore
50. Dallon përdorimin e “shenjës në vend të numrit të panjohur” në mbledhjen e numrave $6 + \quad = 10$;
51. Dallon përdorimin e “shenjës në vend të numrit të panjohur” në zbritjen e numrave $10 - \quad = 6$
52. Lexon dhe shkruan numra deri në 10
53. Lexon dhe fillon të shkruaj numra nga 11 deri 20
54. Ushtrime për lexim dhe shkrim të numrave deri 20 – zberthim i numrave njëshifror dhe dyshifror
55. Përforsim – lexim-shkrim, dhe krahason numrat 1 deri 20 e më shumë.
56. Paraardhësi dhe pasardhësi I numrave deri 20.
57. Numrat rendor – rradhit
58. Numërim deri 100 zbatim I tabelës 100 (qindëshe).
59. Paraardhësi dhe pasardhësi I numrave deri 100
60. Përsëritje e numrave deri 100.
61. Numërim përpara – zbatim I bushtit numerik
62. Mbledhje me numrat deri 6 dhe 7 .
63. Mbledhje me numrat 8 и 9.
64. Përcaktim I numrit të panjohur – cili mungon?
65. Mbledhje deri në numrin 10
66. Detyra me mbledhje - kupton mbledhjen si kombinim i dy sasive.
67. Mbledhje deri më 20 në mënyra të ndryshme
68. Ushtrime për mbledhje .
69. Edhe sa më duhen deri në 10 dhe deri në 20?
70. Fillon të mbledhë numër njëshifror me numër njëshifror dhe numër dyshifror me numër njëshifror deri në 20.
71. Fillon t'i dallojë shenjat ,, + ,, dhe ,, = ,, në shprehjet matematikore
72. Zbritje deri në 20
73. Fillon t'i dallojë shenjat ,, - ,, dhe ,, = ,, në shprehjet matematikore
74. Përcaktim I numrit të panjohur gjatë mbledhjes $6 + \quad = 10$;
75. Përcaktim I numrit të panjohur gjatë zbritjes $10 - \quad = 6$
76. Vetitë komutative –Mbledhje në dy mënyra –(shuma deri 20 dhe më e madhe se 20)
77. Mbledh çift numrash deri më 20 duke filluar nga numri më I madh me numërim.
78. Zberthen numra dyshifror në dhjetëshe dhe njëshe dhe e kundërta .
79. Mbledh më shumë se dy numra.

80. Mbledhje me kalim deri 20 (psh. $4+3+6=10+3=13$ $7+3+4=10+4=14$).
81. Vlerëson rezultatet dhe verifikon me mbledhje ose zbritje rezultatin.
82. Zbret si numërim mbrapa për 1,2,3 –Tabela 100
83. Probleme numerike me mbledhje dhe zbritje
84. Përcaktim I numrit të panjohur, gjatë mbledhjes psh, $4 + \quad = 10$;
85. Përcaktim I numrit të panjohur gjatë zbritjes $10 - \quad = 4$
86. E verifikon (vërteton) përgjigjen e detyrës me zbritje duke i mbledhë përgjigjen me numrin më të vogël.
87. Gjen gjysmën prej numrit çift të sendeve deri në 10
88. Dyfishon çfarëdo numër njëshifror.
89. Përpiqet të ndajë numra deri në 10 që të vërtetojë cilët numra janë çift , e cilat tek.
90. Ndanë sende në dy grupe të njëjta..
91. Numërim nga 10 deri 100 – tabela 100
92. Paraardhësi dhe pasardhësi I numrave deri 100
93. Numrat çift dhe tek deri në 100
94. Cilat numra mungojnë në vargun e numrave?
95. Cili numër është më i madh , më i vogël se numri....
96. Zbatimi i njohurive në zgjidhjen e problemeve me numra dhe bashkimin e pjesëve në tërësi (enigma).
97. Zgjidhja e problemeve Gjen më shumë kombinime, psh. në sa mënyra mundet të radhiten tre sende të ndryshme.
98. Përdor mbledhje ose zbritje për ta zgjedhë një problem të thjeshtë të shprehur gojarisht dhe e paraqet duke shfrytëzuar sende.
99. Zgjidh detyra me kontrollim të përgjigjes me mbledhjen e numrave sipas radhitjeve të ndryshme.
100. Zgjidh detyra me kontrollim të përgjigjes, në detyrat me zbritje ,dhe verifikon përgjigjen me mbledhje të përgjigjes dhe numrit më të vogël.
101. Zgjidhje e detyrave më zbatim të strategjive përkatëse përlllogaritje dhe sqarim të procedurës.
102. Kontrollimi i detyrave me zbritje
103. Orë për përforsim
104. Orë për përforsim
105. Orë për përforsim
106. Orë për përforsim
107. Orë për përforsim

TEMA: GJEOMETRIJA DHE ZGJIDHJA E PROBLEMEVE (20orë)

Njësitë mësimore

1. Njeh, emëron dhe i ndanë format e thjeshta 2 D (rrathë, katrorë, këndrejtë)
2. Njeh dhe emëron këndëdrejtin dhe trekëndëshat
3. Emëron këndrejtët dhe trekandshat duke i dalluar sipas numrit të faqeve, dhe sipas vijave të drejta dhe të lakuara.
4. Emëron dhe i ndanë format e thjeshta 3 D (psh. katror, këndrejt)
5. Sipërfaqet te 3D format (kubin dhe kuadrin) – duke i dalluar sipas numrit të sipërfaqeve dhe sipas sipërfaqeve të rrafshita ose të lakuara.
6. Grupimi i 3D formave (kubi dhe kuadri).
7. Emëron dhe dallon 3D format e thjeshta (cilindrin, konin dhe topin).
8. Sipërfaqe të 3D (cilindri, koni dhe topi). Duke dalluara sipas numrit të sipërfaqeve dhe sipas sipërfaqeve të rrafshita ose të lakuara.
9. Grupimi i 3D formave (cilindri, koni dhe topi).
10. Bën shema dhe modele.
11. Bën shema dhe modele .
12. Dallon vijën themelore të simetrisë.
13. Ka apo ska simetri?
14. Njeh dhe dallon marëdhëniet e thjeshta në mes 2 D и 3 D formave.
15. Vendpozita - para – prapa ,afër- larg, ,nën -mbi
16. Lëvizje sipas udhëzimeve lartë poshtë para – prapa ,nën mbi
17. Dhënja e udhëzime para- prapa
18. Orë për përforcim
19. Orë për përforcim
20. Orë për përforcim

TEMA: MATJE DHE ZGJIDHJA E PROBLEMEVE (20orë)

Njësitë mësimore:

1. Dallon monedhat.
2. Vlera e monedhave
3. Loja „Tregu “. Llogaritje si të paguhet shuma e saktë duke shfrytëzuar monedhat
4. Njeh njësitë e masave të rëndomta jo standarde dhe shrytëzon gjuhën krahasuese
5. Shfrytëzon gjuhë krahasuese, psh. më e gjatë, më e shkurtë,
6. Krahason e trashë - e hollë
7. Krahason e gjerë - e ngushtë
8. Krahason pesha më e rëndë –më e lehtë
9. Krahason e mbushur – e zbrazët .
10. Vlerëson dhe krahason vëllimin me krahasim të drejtëpërdrejtë e pastaj përdor njësitë e masave jostandarde.
11. Njeh dhe kupton dhe përdor njësitë e ndryshme për matjen e kohës,si psh. minutata, ora .
12. Njeh ditët e javës
13. Njeh muajt e vitit
14. Para dhe pas
15. Zbaton strategji përkatëse për llogaritje dhe sqaron procedurën (mënyrën si e ka zgjidhur).
16. Vlerësimi dhe kontrolli i të njejtës.
17. Lexim i kohës (orës).
18. Njeh lexon kohën (orën) dhe i njeh pjesët e ndryshme të ditës. (mëngjes pasdite ,natën).
19. Rradhitë ditët e javës dhe ndodhi të ndryshme të njohura
20. Orë për përforsim.

TEMA: PUNË ME TË DHËNA DHE ZGJIDHJA E PROBLEMEVE (12 orë)

Njësitë mësimore:

1. Punë me të dhëna - njohje
2. Mbledhja e të dhënave dhe punë me tabelë.
3. Lojëra interaktive për klasifikim <http://www.shodor.org/interactivate/activities/BarGraphSorter>
4. Piktograme.
5. Dijagrami i Venit

6. Lojëra interaktive me Diagramitn e Venit. <http://www.shodor.org/interactivate/activities/ShapeSorter>.
7. Organizimi, kategorizimi dhe paraqitja e të dhënave me përdorim të grafikoneve dhe mjeteve praktike.
8. Lexim i rezultateve të paraqitura në lista apo tabela me mjete praktike.
9. Lexim i rezultateve të diagramit të Venit dhe Kerolovit.
10. Lexim i rezultateve të diagramit të Venit dhe Kerolovit duke dhënë kriteret e ndryshme për grupimin e sendeve.
11. Zbatimi i strategjive përkatëse për llogaritje dhe sqarimi i procedurave.
12. Orë për përforsim

3. REKOMANDIMET DIDAKTIKE

Programi i shkurtuar mësimor i lëndës mësimore Matematika për klasën e parë të arsimit fillor nëntëvjeçar përbëhet nga Hyrja, Pasqyra e temave dhe njësive dhe Rekomandimeve didaktike. Planifikimi i mësimin sipas programit të shkurtuar duhet të jetë në përputhshmëri me Planin mësimor dhe të përfshijë qëllimet, rezultatet e pritura, nocinet e përcaktuara në program për përmbajtjet mësimore.

Njësitë mësimore nga programi i shkurtuar mësimor nga lënda e matematikës për klasë të parë realizohen me orë të shkurtuara mësimore që zgjasin 30 minuta. Gjatë realizimit të orës mësimore ku përpunohet përmbajtja e re mësimore, ora duhet të ketë pjesën hyrëse, aktivitetet e të mësuarit dhe të nxënësve dhe pjesën përfundimtare apo përmbjllëse të orës. Pjesa hyrëse duhet të zgjasë më së paku 5 minuta. Këtë pjesë të orës mësimore duhet filluar përmes pyetjeve, prezentimit të fotove, aplikacioneve dhe shfrytëzimit të metodave e teknikave të ndryshme për punë. Duke u nisur nga parnjohuritë e nxënësve ndërtojmë apo zgjerojmë njohuritë e reja. Duhet të fokusohemi tek aktivitetet e të nxënësve të mësuarit sepse, ky proces është mirë që të zhvillohet përmes hulumtimit, përvetësimit, praktikimit të njohurive të reja, ku ata i zgjerojnë njohuritë që kanë, e arsimtari udhëzon, tregon, sqaron zgjidh detyra përshkruan sqaron nocionet me gjuhë që nënësi i kësaj moshe e kupton, Arsimtari u ndihmon që ta mësojnë në mënyrë sa më të lehtë. Pjesa përfundimtare e orës mësimore duhet të zgjasë 5 minuta, kur rezykohet (përmblihet) se çfarë është punuar gjatë orës mësimore.

Duke pasur parasysh mundësitë zhvillimore, interesat e nxënësve të moshës 6 vjeçare si dhe karakteristikat e moshës zhvillimore të kësaj periudhe fëmijërore është i domosdoshëm mësimi përmes lojës didaktike, përdorimit të manipulativëve ose konkretizimit, hulumtimit etj. Shumë me rëndësi është që arsimtari të zgjedh material të përshtatshëm për punë me nxënës si dhetë ju jap kohë të mjaftueshme dhe hapësirë për aktivitete mësimore..

Gjatë realizimit të përmbajtjeve të matematikës, domosdoshmërisht duhet të zbatohet metoda e zgjidhjes së problemeve që mundëson zbatimin e të mësuarit induktiv.

Arsimtari, gjithashtu duhet të sigurojë që të gjithë nxënësit të marrin pjesë në aktivitet duke respektuar protokolet për distancë fizike dhe mbrojtje personale

Duke respektuar qasjen holistike në punë me nxënësit e kësaj moshe arsimtari gjatë planifikimit të mësimit dhe realizimit të orëve mësimore bën integrimin i lëndës mësimore matematika me lëndët e tjera si: Shoqëria, Arsimi fizik dhe shëndetësor, Arsimi figurativ etj.

Duke u nisur nga qëllimet e mësimit, çdokund ku ka mundësi gjatë procesit të të mësuarit, është mirë që të, ju mundësohet nxënësve zgjedhje e aktiviteteve të ndryshme dhe përmbajtjeve në përputhje me interesat e tyre subjektive dhe mundësive zhvillimore të tyre.

Metodat më efikase për mësimin e lëndës së Matematikës janë ato metoda që nxënësit i venë pozita të përshtatshme e aktive në procesin e nxënies së njohurive të reja. Është e nevojshme që arsimtari të krijojë situata të të mësuarit, ku do të vijë në shprehje aktivitetet të llojllojshme që mundësojnë mënyra të ndryshme të të nxënësve.

4. Normativi për kuadrin mësimor

Programin e shkurtuar mësimor e realizon arsimtari në përputhje me normativin për kuadrin mësimor të dhënë në programin e rregullt mësimor.

Programi i shkurtuar mësimor i lëndës mësimore Matematika për klasën e parë të arsimit fillor nëntëvjeçar e miratohet

MINISTERI ARSIMIT DHE SHKENCËS

MILA CAROVSKA